



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 11

2000

Prill

P Ë R M B A J T J A

Vendim i K.M nr.159, datë 7.4.2000	Për zbatimin e ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë"	465
Vendim i K.M nr.163, datë 13.4.2000	Për shpërndarjen me koeficient pjesor të vlerave financiare kreditorëve të shoqërisë "Global-Foods" sh.p.k, në administrim.....	465
Vendim i K.M nr.165, datë 13.4.2000	Për një shtesë në vendimin nr.579, datë 8.9.1998 të Këshillit të Ministrave "Për caktimin e rregullave për kthimin e vlerave financiare kreditorëve që kanë depozituar kapitalet e tyre pranë shoqërive huamarrëse".....	466
Vendim i K.M nr.167, datë 13.4.2000	Për një ndryshim në vendimin nr.505, datë 24.10.1994, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me ushqim të kuadrove ushtarakë, aktivë që shërbejnë në strukturat e ushtrisë"	467
Vendim i K.M nr.184, datë 21.4.2000	Për miratimin e rregullores së punës, "Për funksionimin e Komisionit Qendror për grumbullimin e armëve në Republikën e Shqipërisë"	468

Vendim i K.M nr.197, datë 29.4.2000	Për shpalljen "Dëshmorë të Atdheut".....	468
Vendim i K.M nr.199, datë 29.4.2000	Për miratimin e projektkontratës për blerjen e aksioneve dhe të instruksioneve për paraqitjen dhe hapjen e ofertave për privatizimin e "Albanian Mobile Communication (AMC) sh.a.".....	471
Vendim i K.M nr.200, datë 29.4.2000	Për një ndryshim në vendimin nr.166, datë 11.4.1997, të Këshillit të Ministrave, "Për sigurimin dhe administrimin e ndihmave humanitare dhe të emergjencës".....	471
Vendim i K.M nr.201, datë 29.4.2000	Për plotësimin e pjesës shtetërore të kapitalit në Bankën Italo- Shqiptare.....	472
Vendim i Gj.K nr.16	Me objekt "Shfuqizimi si antikushtetues të shtesës së nenit 1 të Ligjit nr.7916, datë 12.4.1995 "Për disa ndryshime në Ligjin nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve".....	472
Vendim i Gj.K nr.17	Me objekt "Shfuqizimi si antikushtetues të vendimit nr.386, datë 29.7.1999 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë".....	479
Vendim i Gj.K nr.18	Me objekt "Shfuqizimi si antikushtetues të vendimit nr.756, datë 29.6.1999 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë".....	484
Vendim i Gj.K nr.19	Me objekt "Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.1114, datë 7.12.1999 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë".....	488
Vendim i Gj.K nr.20	Me objekt "Deklarim antikushtetues të vendimeve nr.998, datë 3.12.1998 të Gjykatës së rrethit Tiranë dhe nr.378, datë 23.6.1999 të kolegjit penal të Gjykatës së Lartë".....	490

V E N D I M
Nr. 159, datë 7.4.2000

**PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7703, DATË 11.5.1993, “PËR SIGURIMET SHOQËRORE
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 32 dhe 59, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Koeficientët e shtesës së bazës së vlerësuar vjetore, individuale, për llogaritjen fillestare të pensioneve, në mbështetje të pikës 3, të nenit 59, të ligjit nr. 7703. datë 11.5. 1993, të jenë

për vitin 1999	1
për vitin 1998	1.05
për vitin 1997	$1 \times 1.05 \times 1.22 = 1.28$
për vitin 1996	$1 \times 1.05 \times 1.22 \times 1.09 = 1.40$
për vitin 1995	$1 \times 1.05 \times 1.22 \times 1.09 \times 1.37 = 1.91$
për vitin 1994	$1 \times 1.05 \times 1.22 \times 1.09 \times 1.37 \times 1.32 = 2.53$

2. Efektet financiare, në çastin e llogaritjes fillestare të pensioneve, si rrjedhojë e zbatimit të koeficientëve të përcaktuar në pikën 1, të përballohen nga fondi i miratuar për vitin 2000 për Insitutin e Sigurimeve Shoqërore.

3. Vendimi nr.388, datë 19.8.1999, i Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin e ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë””, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2000.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.163, datë 13.4.2000

**PËR SHPËRNDARJEN ME KOEFICIENT PJESOR TË VLERAVE FINANCIARE
KREDITORËVE TË SHOQËRISË “GLOBAL-FOODS” SH.P.K., NË ADMINISTRIM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 6 të ligjit nr.8215, datë 9.5.1997, “Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, dhe të neneve 3, 4 e 8, pika 3, të ligjit nr. 8360, datë 10.6.1998, “Për kriteret dhe mënyrën e shpërndarjes së pasurive të personave juridikë jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshillit të Ministrave

V E N D O S I :

1. Fillimin e procesit të kompensimit të pjesshëm të vlerave financiare kreditorëve të shoqërisë “Global-Foods” sh.p.k., në administrim.

2. Shuma e detyrimit të mbetur që shoqëria “Global-Foods” sh.p.k. në administrim ka ndaj kreditorëve të saj është 230 479 375 lekë.

Koeficienti pjesor i kthimit të vlerave financiare kreditorëve të shoqërisë “Global-Foods”

sh.p.k. në administrim, të jetë 0.5 ose 50 për qind.

3. Ngarkohet Banka e Kursimeve me degët e saj në rrethet Berat, Kuçovë, Skrapar dhe Tiranë për shpërndarjen e vlerave financiare kreditorëve të shoqërisë “Global-Foods” sh.p.k., në administrim.

4. Shpenzimet për shërbimet që do të kryhen në sportelet e degëve të kësaj banke përballohen nga zëri “Shpenzime” i buxhetit të vitit 2000 miratuar për Grupin e Mbikqyrjes.

5. Ngarkohet Banka e Kursimeve, Grupi i Mbikqyrjes dhe administratori i caktuar me vendim nr.209, datë 28.04.1999, të Këshillit të Ministrave për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.165, datë 13.4.2000

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.579, DATË 8.09.1998 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR CAKTIMIN E RREGULLAVE PËR KTHIMIN E VLERAVE
FINANCIARE KREDITOREVE QË KANË DEPOZITUAR KAPITALET E TYRE PRANË
SHOQËRIVE HUAMARRËSE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 8, të ligjit nr.8360, datë 10.06.1998, “Për kriteret dhe mënyrën e shpërndarjes së pasurive të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë” me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave:

V E N D O S I :

1. Pas paragrafëve të dytë dhe të katërt, të pikës 11, të vendimit nr.579, datë 8.09.1998, të Këshillit të Ministrave, shtohen përkatësisht këto paragrafe me këtë përmbajtje:

“Përjashtimisht lejohet tërheqja e shumave me prokurë kur vetë kreditori, ose së bashku me familjen e tij është larguar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe kthimi paraqet vështirësi, kreditori, për shkak sëmundjeje, me vendim gjykate ka humbur aftësinë apo zotësinë për të vepruar dhe për të miturit nën moshën 18 vjeç”.

“Kur kreditori, për shkaqe të përligjura si djegje, grabitje apo përmbajtje banese, ka humbur kontratën origjinale të huadhënies dhe pranë shoqërisë ekziston kopja e dokumentacionit, administratorët e përbashkët kanë të drejtë të pajisin kreditorin me dublikatë, si dhe të njoftojnë Bankën e Kursimeve për kryerjen e veprimit të pagesës”

2. Për rastet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, personat e autorizuar për të tërhequr, pranë sporteleve të Bankës të Kursimeve, vlera financiare, paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- Prokurën.
- Kontratën origjinale të huadhënies ose dublikatën e lëshuar nga administratorët e përbashkët.
- Mandatpagesën origjinale ose dublikatën.
- Kopjen e noterizuar të letërnjoftimit, të pasaportës, apo të çertifikatës me fotografi të kreditorit.
- Vendimin e gjykatës, për personat që u është hequr zotësia për të vepruar.
- Çertifikatën familjare për të miturit nën moshën 18 vjeç.
- Letërnjoftimin, pasaportën apo çertifikatën me fotografi të personit që autorizohet për tërheqjen e vlerave financiare.

3. Kur kreditori ka vdekur, personi që paraqitet për të tërhequr vlerat financiare, i dorëzon

Bankës së Kursimeve dokumentacionin e përcaktuar në pikën 2 të vendimit, duke zëvendësuar prokurën me aktin e trashëgimisë.

4. Ngarkohet Grupi i Mbikqyrjes, Banka e Kursimeve dhe administratorët e shoqërive huamarrëse për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta

V E N D I M

Nr.167, datë 13.4.2000

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.505, DATË 24.10.1994, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR TRAJTIMIN ME USHQIM TË KUADROVE USHTARAKË, AKTIVË QË SHËRBEJNË NË STRUKTURAT E USHTRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1, 12 dhe 21, të ligjit nr.8321, datë 2.4.1998, “Për policinë e burgjeve”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Në vendimin nr.505, datë 24.10.1994, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:
 - Në fund të titullit të vendimit shtohen fjalët “dhe të policisë së burgjeve”.
 - Në pikat 1 dhe 3 të vendimit, pas fjalëve “...ushtarakët e shërbimit aktiv, të përhershëm” shtohen fjalët “dhe në policinë e burgjeve”, kurse në pikën 2, pas fjalëve “ushtarakët e tjerë të shërbimit aktiv të përhershëm”, shtohen fjalët “dhe të policisë së burgjeve”.
 - Në pikat 3, 4 dhe 5, pas fjalëve “...Ministrisë së Brendshme e të Shërbimit Informativ Kombëtar”, shtohen fjalët “dhe të policisë së burgjeve”.
2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2000 për Ministrinë e Drejtësisë.
3. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë të nxjerrë udhëzimin përkatës në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta

V E N D I M

Nr. 184, datë 21.4.2000

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË PUNËS, “PËR FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT QENDROR PËR GRUMBULLIMIN E ARMËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6, të ligjit nr. 8388, datë 5.8.1998, “Për grumbullimin e armëve dhe municioneve luftarake”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Miratimin e rregullores së punës “Për funksionimin e komisionit qendror për grumbullimin e armëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Ngarkohet ministri i Rendit Publik, ministri i Mbrojtjes dhe ministri i Pushtetit Lokal dhe komisioni qendror për grumbullimin e armëve dhe të municioneve luftarake për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 197, datë 29.4.2000

PËR SHPALLJEN “DËSHMORË TË ATDHEUT”

Në bazë të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 1, të dekretit nr. 7199, datë 29.1.1998, “Për një ndryshim në dekretin nr.4558, datë 18.10.1969, “Për Dëshmorët e Atdheut”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Të shpallen “Dëshmorë të Atdheut” 74 të internuar që kanë vdekur në kampet e përqendrimit nazist gjatë Luftës së Dytë Botërore, sipas listës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

LISTA EMËRORE E 74 PERSONAVE NGA RRETHI I VLORËS TË INTERNUAR DHE TË VDEKUR NË KAMPET NAZISTE QË PROPOZOHEN PËR T’U SHPALLUR “DËSHMORË TË ATDHEUT”

Nr.	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI
1.	Andrea	Nasho	Gerverni
2.	Arshi	Sejdi	Danaj
3.	Athanas	Thanas	Babe
4.	Aleks	Dhimo	Gjidede
5.	Arif	Hamza	Lepuri
6.	Asim	Daut	Çenaj
7.	Barjam	Bexhet	Myftari
8.	Behar	Isak	Mustafaraj
9.	Beqir	Sulo	Agalliu
10.	Brahim	Hamza	Gumbardhi
11.	Dude	Spiro	Papaj
12.	Dervish	Dule	Troka
13.	Dule	Metush	Sadiraj
14.	Dhimitër	Pandeli	Strati
15.	Enver	Asllan	Karafili
16.	Fuat	Meto	Bocaj

17.	Farudin	Selfo	Rustemi
18.	Hasim	Seit	Dauti
19.	Hasan	Daut	Dauti
20.	Hamza	Hamza	Bleta
21.	Habib	Hamza	Koka
22.	Hasan	Daut	Çani
23.	Hamdi	Shehap	Dervishi
24.	Irfan	Ahmet	Shehu
25.	Ismail	Selfo	Harizaj
26.	Lili	Lluk	Mino
27.	Loni	Vasil	Samarxhi
28.	Musa	Xhelo	Brahimi
29.	Mehmet	Sulo	Agalliu
30.	Myzafer	Elmaz	Velaj
31.	Malo	Idris	Ismaili
32.	Memsur	Isak	Mustafaraj
33.	Mahmut	Hazbi	Xhelo
34.	Mehdi	Rakip	Musta
35.	Mystehak	Hamza	Gumbardhi
36.	Mihal	Ndin	Shyti
37.	Mërkur	Jani	Minga
38.	Niko	Ciko	Lato
39.	Nikodhim	Ndin	Shyti
40.	Niko	Janaq	Çika
41.	Joti	Foti	Profi
42.	Jani	Kozma	Janka
43.	Jani	Taqi	Haxhimihali
44.	Riza	Jaup	Tafili
45.	Refat	Haxhi	Mustafaraj
46.	Rexhep	Idris	Toto
47.	Kristaq	Dhimitër	Gjyli
48.	Kristofor	Dhimitër	Gjyli
49.	Llazar	Kristo	Beqari
50.	Osmën	Rakip	Osmëni
51.	Pavlllo	Jani	Doga
52.	Pilo	Gole	Gaçe
53.	Piro	Jani	Minga
54.	Qendro	Nasho	Gerverni
55.	Qerim	Bame	Xhelili
56.	Qako	Dhimitër	Lamani
57.	Qani	Hariz	Spahiu
58.	Ramadan	Hajrulla	Hajrullahu
59.	Sezai	Xhelo	Seferi
60.	Seit	Musa	Qemali
61.	Siko	Naqo	Sinani
62.	Spiro	Niko	Suli
63.	Shyqyri	Mahmut	Tare
64.	Shuaip	Fejzo	Velaj
65.	Tasim	Isuf	Jonuzi
66.	Thoma	Vasil	Karagjozi
67.	Gori	Stefan	Sota

68.	Gjysh	Arif	Mihali
69.	Ziaudin	Rakip	Osmëni
70.	Zoi	Lili	Lengu
71.	Vllasi	Llambi	Kuqo
72.	Qerim	Asim	Arapi
73.	Sadedin	Ali	Selfo
74.	Irakli	Thoma	Isaija

V E N D I M
Nr.199, datë 29.4.2000

PËR MIRATIMIN E PROJEKTKONTRATËS PËR BLERJEN E AKSIONEVE DHE TË INSTRUKSIONEVE PËR PARAQITJEN DHE HAPJEN E OFERTAVE PËR PRIVATIZIMIN E “ALBANIAN MOBILE COMMUNICATION (AMC), SH.A.”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12, të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998, “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë“, dhe të nenit 6, të ligjit nr.8515, datë 21.7.1999, “Për privatizimin e shoqërisë anonime “Albanian Mobile Communication (AMC)””, me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e projektkontratës për blerjen e aksioneve të AMC, sh.a., si dhe instruksionet për paraqitjen dhe hapjen e ofertave për privatizimin e kësaj shoqërie.
 2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 200, datë 29.4.2000

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.166, DATË 11.4.1997, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SIGURIMIN DHE ADMINISTRIMIN E NDIHMAVE HUMANITARE DHE TË EMERGJENCËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 1, të ligjit nr.7815, datë 20.4.1994, “Për barnat”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Paragrafi i dytë i pikës 2 në vendimin nr.166, datë 11.4.1997, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si vijon:
“- Ministria e Shëndetësisë, për ndimat humanitare në barna, materiale dhe aparatura mjeksore.

Barnat dhe materialet mjeksore, ndihmë humanitare, që u dhurohen institucioneve shëndetësore, shqiptare, duhet të plotësojnë parametrat e parashikuara në ligjin nr.7815, datë

20.4.1994, "Për barnat".

Këto ndihma humanitare, të dhuruara i kalojnë, sipas rregullave të caktuara nga Ministria e Shëndetësisë, institucionit shëndetësor, kur i dhurohen atij, dhe Fufarmës, kur i dhurohen Ministrisë së Shëndetësisë."

2. Vendimi nr.169, datë 8.4.1999, i Këshillit të Ministrave "Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.166, datë 11.4.1997, "Për sigurimin dhe administrimin e ndihmave humanitare dhe të emergjencës"", shfuqizohet.

3. Ngarkohet ministri i Shëndetësisë të nxjerrë aktet përkatëse, në zbatim të këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 201, datë 29.4.2000

**PËR PLOTËSIMIN E PJESËS SHTETËRORE TË KAPITALIT NË BANKËN
ITALO-SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe nenit 1, të ligjit nr.8592, datë 30.3.2000, "Për emetimin e bonove të thesarit, me terma dhe kushte tregtare", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Autorizohet Ministria e Financave që të bëjë pagesën në CASH të kundërvlerës në lekë shqiptare, të shumës prej 1 950 000 (një milion e nëntëqindpesëdhjetë mijë) USD-sh për plotësimin e pjesës shtetërore, që rezultojnë e papaguar në kapitalin e bankës "Italo-Shqiptare".

2. Shuma e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi të paguhet duke përdorur kursin e këmbimit me dollarin amerikan, të publikuar nga Banka e Shqipërisë, në ditën e hyrjes së pagesës.

3. Shpenzimet të përballohen nga fondet e miratuara për ristrukturimin e bankave në buxhetin e vitit 2000 për Ministrinë e Financave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
"NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Sabri Rrapi,	Anëtar i " "
Zija Vuci,	Anëtar i " "
Hajredin Fuga,	Anëtar i " "
Alfred Karamuço,	Anëtar i " "
Bardha Selenica,	Anëtar i " "
Kristofor Peçi,	Anëtar i " "
Kujtim Puto,	Anëtar i " "
Sokol Sadushi,	Anëtar i " "

me sekretare Drita Filto e Arbenka Lalica, në datat 12.01.2000; 13.01.2000; 28.01.2000 dhe 09.03.2000, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.64/2 Akti që i përket:

KËRKUES: 1. Bashkia Ura Vajgurore, e përfaqësuar nga Dule Sako, me autorizim. 2. Bashkia Vlorë, përfaqësuar nga Vaso Strakosha, me autorizim. 3. Bashkia Kuçovë, përfaqësuar nga avokat Hajri Shehu, me autorizim. 4. Dega e Shoqatës së Qiramarrësve të Banesave Shtetërore ish pronë private, Durrës përfaqësuar nga avokatët Hajri Shehu dhe Sadik Qorduka me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Viktor Gumi.
2. Këshilli i Ministrave përfaqësuar nga zoti Ilir Panda, Ministër i Drejtësisë.
3. Shoqata Kombëtare e të Shpronësuarve “Pronësi me Drejtësi, përfaqësuar nga avokat Agim Tartari.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i shtesës së nenit 1 të Ligjit nr.7916, datë 12.04.1995 “Për disa ndryshime në Ligjin nr.7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”.

Gjykata Kushtetuese ka vendosur të bashkojë shqyrtimin e kërkesave të sipërpërmendura në një gjykim të vetëm, meqenëse ato kanë të bëjnë me shfuqizimin si antikushtetues të frazës “...duke përfshirë edhe Ligjin nr.37, datë 13.01.1945 “Për tatimin e jashtëzakonshëm...” të ligjit të sipërcituar. Kërkesit kanë parashtruar argumentet e mëposhtme:

- Ligji nr.7916, datë 12.04.1995 cënon parimin kushtetues të barazisë së shtetasve para ligjit;

- Ligji nr.37 i vitit 1945 për tatimin e jashtëzakonshëm ka qenë një masë fiskale dhe jo politike dhe sekuestrimi i pasurisë ndaj subjekteve, që detyroheshin në bazë të këtij ligji, u bë vetëm në ato raste kur ata iu shmangën shlyerjes së tatimeve të jashtëzakonshme në vlerë leku;

- Ligji nr.7916, datë 12.04.1995 prek ata persona që banojnë si qiraxhinj me shtetin në shtëpitë e sekuestruara për mosshlyerje të tatimit të jashtëzakonshëm, duke krijuar një problem tjetër social, problemin e sistemit të të pastrehëve.

GJYKATA KUSHTETUESE

Pasi dëgjoi përfaqësuesit e kërkesave, të subjekteve të interesuara dhe e bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Neni 1 i Ligjit nr.7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish pronarëve” si dhe dispozitat e tjera të tij, u njohin të drejtën e pronësisë ish-pronarëve ose trashëgimtarëve të tyre për pronat e shtetëzuara, të shpronësuara ose të konfiskuara nga shteti pas datës 29 nëntor 1944, ose të marra padrejtësisht me çdo mënyrë tjetër.

Me miratimin e këtij ligji, ligjvënësi bëri një përpjekje për të ndrequr, në përputhje me frymën e së drejtës në përgjithësi e të normave ndërkombëtare, ato padrejtësi të krijuara nga shteti i asaj kohe, i cili, zhveshi arbitrarisht nga e drejta e pronësisë një kategori jo të vogël qytetarësh.

Në bazë të këtij ligji, pronat që kaluan padrejtësisht në pronësi të shtetit, kryesisht për motive politike, iu kthehen ose kompensohen kësaj kategorie qytetarësh. Nisur nga përmbajtja dhe zgjidhja që iu dha në praktikë kësaj dispozite ligjore, organet shtetërore, të ngarkuara me kthimin dhe kompensimin e pronave në bazë të këtij ligji, e zbatuan atë duke përcaktuar si subjekte të tij vetëm këtë kategori pronarësh. Sipas këtij kuptimi përjashtoheshin nga përfitimi ata subjekte, të cilëve, për shkak të mospagimit të detyrimit fiskal u është sekuestruar prona në favor të shtetit në zbatim të Ligjit nr.37 të vitit 1945 “Për tatimin e jashtëzakonshëm për fitimet e luftës”.

Ligji nr.7916, datë 12.04.1995, “Për disa ndryshime në Ligjin nr.7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” i bën një shtesë nenit 1 të sipërcituar, me të cilën zgjerohet rrethi i subjekteve përfitues të tij. Sipas kësaj shtese, subjekte përfitues janë edhe personat, të cilëve shteti u ka sekuestruar pronat në zbatim të Ligjit nr.37 datë 13.01.1945 “Për tatimin e jashtëzakonshëm”.

Gjykata Kushtetuese çmon se kjo shtesë që iu bë ligjit në vitin 1995 nuk është në përputhje me kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare.

Gjykata Kushtetuese konkludon se qëllimi i miratimit të Ligjit nr.37 datë 13.01.1945 “Për tatimin e jashtëzakonshëm”, ka qenë vendosja e tatimit të jashtëzakonshëm ndaj fitimeve të mëdha të realizuara nga shtetas dhe nga të huaj në Shqipëri gjatë ushtrimit të veprimtarive tregtare, industriale dhe ndërmjetëse që prej datës 7 prill 1939 deri në datën 31 dhjetor 1944. Kjo kategori subjektësh që i nënshtrohej këtij ligji nuk është dhe nuk mund të barazohet me ish-pronarët e tjerë, pronat e të cilëve u shpronësuan ose u shtetëzuan jo për një motiv të tillë fiskal.

Nisur nga pretendimi i Shoqatës Kombëtare të të shpronësuarve “Pronësi me Drejtësi”, se Ligji nr.37 datë 13.01.1945 “Për tatimin e jashtëzakonshëm” nuk është zbatuar drejt dhe se ligjvënësi ka patur si qëllim eliminimin e klasës së tregtarëve, Gjykata Kushtetuese çmon se nuk është në kompetencën e saj të analizojë mënyrën e zbatimit të atëhershëm në praktikë të këtij ligji, pasi kjo ka qenë dhe mbetet detyrë e komisioneve të kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve si dhe e gjykatave të zakonshme të ngarkuara nga ligji për të zgjidhur konfliktet për çështje të tilla.

Vendosja e ligjit për tatimet e jashtëzakonshme nuk ka qenë një fenomen thjeshtë shqiptar. Një praktikë e tillë është zbatuar pas Luftës së Dytë Botërore edhe në vende të tjera perëndimore dhe ajo është çmuar si masë e marrë në përputhje edhe me normat e gjithëpranuara të së drejtës ndërkombëtare.

Shtesa e parashikuar në ligjin nr.7916, datë 12.04.1995, ku i njihet e drejta e pronësisë edhe atyre personave që u është sekuestruar pasuria nga ligji “Për tatimin e jashtëzakonshëm”, e barazon padrejtësisht këtë masë me karakter fiskal me zhveshjen e padrejtë të pronës njëlloj si dhe në rastet e tjera që parashikon kjo dispozitë.

Neni 1, paragrafi i dytë i Protokollit nr.1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, njeh të drejtën e shteteve për të miratuar ligjet që ato i çmojnë të domosdoshëm për të siguruar pagesën e taksave, të kontributeve të tjera, ose të gjobave. Sipas neneve 5, 116 dhe 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kjo normë e së drejtës ndërkombëtare është e zbatueshme dhe ka përparësi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të. Ajo do të thotë se ligjvënësi mund të hartojë ligje që parashikojnë edhe privim të së drejtës së pronës, kur kjo masë çmohet e domosdoshme për të siguruar pagimin e detyrimeve me karakter fiskal. Sipas kuptimit të normave kushtetuese e ndërkombëtare të lartpërmendura dhe vetëm për këto qëllime, prona e sekuestruar trajtohet si pronë e ligjshme shtetërore, e cila gëzon të njëjtën mbrojtje me ligj ashtu si dhe ajo private në kuptim edhe të nenit 11 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Duke shqyrtuar çështjen në këtë këndvështrim, kur ligjvënësi i ka bërë shtesë nenit 1 të Ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, ai nuk ka marrë në konsideratë këtë normë të së drejtës ndërkombëtare dhe as Ligjin nr.7941, datë 29.04.1991 “Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese”, neni 8 i të cilit parashikonte se: “Legjislacioni i Republikës së Shqipërisë merr parasysh, njeh dhe respekton parimet dhe normat përgjithësisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare”.

Megjithëse kjo shtesë e Ligjit të lartpërmendur ka sjellë efektet e veta juridike, Gjykata Kushtetuese, e vënë në lëvizje nga katër kërkesa subjektësh, ka vendosur të shqyrtojë këto çështje, duke e konsideruar këtë si detyrim kushtetues të saj. Gjithashtu meqenëse Gjykata Kushtetuese çmon se shtesa që i është bërë ligjit të sipërcituar bie në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, dhe se ajo nuk mund të pranojë ekzistencën e antikushtetutshmërisë në legjislacion, në bazë të nenit 132 të Kushtetutës, ajo ka vetëm të drejtën e shfuqizimit të aktit që shqyrton, me qëllim edhe të parandalimit të antikushtetutshmërisë. Ky është edhe kuptimi i nenit 178, pika , dhe i nenit 181, pika 2, të Kushtetutës, sipas të cilëve, ligjet e miratuara përpara hyrjes në fuqi të Kushtetutës do të zbatohen vetëm kur nuk vijnë në

kundërshtim me të.

Gjykata Kushtetuese çmon se nuk duhet pranuar pretendimi tjetër i kërkuesve, sipas të cilit kjo shtesë e ligjit cënon edhe parimin e barazisë së shtetasve përpara ligjit. Parimi i barazisë para ligjit nuk shkelet nëse vërehet se nuk i është dhënë zgjidhje e njëjlojtë çështjeve lidhur me subjekte, të cilët ndodhen në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia në ligj dhe para ligjit parakupton barazinë e individëve që ndodhen në kushte të barabarta. Ky përbën edhe një qëndrim tashmë të konsoliduar në praktikën e Gjykatës Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 dhe 132 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe në nenet 72 e 86 të Ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë“, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Shfuqizimin si të papajtueshën me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të shprehjes, “duke përfshirë edhe Ligjin nr.37, datë 13.01.1945 “Për tatimin e jashtëzakonshëm” në nenin 1 të Ligjit nr.7916, datë 12.04.1995 “Për disa ndryshime në Ligjin nr.7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 17.04.2000
Nr.64/2 i Regj. Themeltar.
Nr. 16 i Vendimit.

MENDIMI I PAKICËS

Kërkesa duhej të rrëzohej si e pabazuar, pasi nuk parashtron asnjë shkelje me karakter kushtetues.

Pretendimi kryesor që ngrihet në kërkesë është se ndryshimi që i është bërë nenit 1 të Ligjit nr.7698, datë 15.03.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, cënon parimin e barazisë së shtetasve para ligjit. Ky pretendim është i pabazuar dhe rrëzohet me vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Pretendimet e tjera nuk kanë të bëjnë me karakterin antikushtetues të ndryshimit të ligjit, por me vlerësim të tij sipas interesit të kërkuesit, dhe në këtë këndvështrim nuk përbëjnë objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese.

Nga ana tjetër, zgjidhja që i është bërë çështjes me vendimin e shumicës, mbart në vetvete një kontradiktë të hapur. Kështu, pranohet se shtesa që i është bërë nenit 1 të Ligjit në vitin 1995, bie në kundërshtim me Kushtetutën, për arsye që përmenden në vendim, duke marrë për bazë interesat e kërkuesve. Por, duhet theksuar se po kaq e vërtetë është se bie në kundërshtim me Kushtetutën edhe shfuqizimi i këtij ndryshimi, parë nga këndvështrimi i interesave të ish-pronarëve.

Mendoj se për zgjidhjen e drejtë të çështjes, duhet të merret në konsideratë qëllimi i Ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”. Në nenin 1 të ligjit, përcaktohet se u njihet ish-pronarëve e drejta e pronësisë për pronat e shtetëzuara, që shpronësuara apo të konfiskuara, sipas akteve ligjore e nënligjore e vendimeve të gjykatës, ose të marra pa të drejtë nga shteti me çdo mënyrë tjetër. Pra, qëllimi i ligjit është që t’u kthehen pronat e marra pa të drejtë. Mënyrat e marrjes së padrejtë janë: a) sipas akteve ligjore, nënligjore e vendimeve të gjykatës dhe b) me çdo mënyrë tjetër. Me fjalë të tjera, marrja padrejtësisht nga shteti e pronave të ish-pronarëve, është bërë edhe nëpërmjet akteve ligjore e nënligjore. Një nga këto akte, sipas ndryshimit që iu bë nenit 1 në vitin 1995, është dhe Ligji nr. 37, datë 13.01.1945 “Për tatimin e

jashtëzakonshëm”. Zbatimi i nenit 1, duke përfshirë dhe Ligjin nr.37, ka për qëllim që prona e marrë padrejtësisht t’u kthehet ish-pronarëve. Kjo e drejtë garantohet edhe nga neni 41 i Kushtetutës. Edhe Gjykata Kushtetuese, në vendimin e saj që ka të bëjë me paragrafin e parë të nenit 10 të Ligjit nr.7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, ka konfirmuar qëndrimin e ligjvënësit që ndërtesat e tjetërsuara në prona të treta, t’u kthehen ish-pronarëve.

Duke e parë çështjen në aspektin e kontrollit kushtetues, kam mendimin se shtesa që iu bë nenit 1 të ligjit, duke përfshirë edhe Ligjin nr.37, datë 13.01.1945, nuk ka përmbajtje antikushtetuese, përkundrazi, respekton e zbaton parimet dhe kërkesat e nenit 41 të Kushtetutës.

ANËTAR
K.Peçi

MENDIMI I PAKICËS

Jam kundër vendimit të shumicës që vendosi shfuqizimin si antikushtetues të shprehjes “...duke përfshirë edhe ligjin nr.37, datë 13.01.1945 “Për tatimin e jashtëzakonshëm” të nenit 1 të Ligjit nr.7916 datë 12.04.1995 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7698 datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish pronarëve”, për këto arsye:

Në kërkesën e shoqatës së Qiramarrësve të Banesave Shtetërore ish Pronë Private, dega Durrës, si dhe në kërkesat e Bashkisë Vlorë, Ura Vajgurore, etj, parashtrohen si shkak për shfuqizimin e nenit 1 të Ligjit 7916, datë 12.04.1995 fakti se Ligji nr.37, datë 13.01.1945 “Për tatimin e jashtëzakonshëm”, ka qenë një masë me karakter fiskal e jo politik dhe se neni 1 i ligjit 7916, datë 12.04.1995, cënon parimin e barazisë shtetasve para ligjit.

Kam mendimin se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të vlerësojë karakterin e ligjit nr.37, datë 13.01.1945 “Për tatimin e jashtëzakonshëm” dhe as mënyrën e zbatimit të tij. Askush nuk vë në dyshim të drejtën e shtetit për vendosjen e detyrimeve fiskale, siç thuhet në vendimin e shumicës, por kryesorja që i mungon vendimit është se nuk tregohet në të se me cilën dispozitë të Kushtetutës vjen në kundërshtim ligji që kërkohet të shfuqizohet si antikushtetues. Po kështu nuk qëndron pretendimi i kërkuesve për shkeljen e parimit të barazisë para ligjit, sepse siç është shprehur Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj Nr.11, datë 27.03.1993 “Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllajta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia në ligj dhe para ligjit presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”. Edhe në vendimin e shumicës ky arsyetim pranohet.

Prandaj, pretendimet e ngritura nga kërkuesit nuk përbëjnë shkak për antikushtetutshmërinë e ligjit. Sipas nenit 48 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, “Kufijtë e shqyrtimit të çështjes janë brenda objektit të kërkesës dhe shkaqeve të parashtruara në të”. Meqenëse pala kërkuese nuk paraqiti shkaqe të tjera, veç atyre të përmendura më sipër, kërkesa e saj duhej rrëzuar.

Ligji nr.7916, datë 12.04.1995 i ka dhënë efektet e veta. Në zbatim të tij, me vendime të Komisionit të Kthimit të Pronave apo të vendimeve gjyqësore, pronat u janë kthyer ish pronarëve. Nga ana tjetër, sipas nenit 76 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000, Vendimi i Gjykatës Kushtetuese që ka shfuqizuar një ligj, me përjashtim të rasteve të përmendura në pikën 2, nuk ka efekte parapavepruese. Në këtë vështrim shfuqizimi i një ligji që i ka përfunduar efektet nuk mund të ndryshojë marrëdhëniet juridike që kanë ardhur si rezultat i zbatimit të tij, prandaj në thelb më duket i pa kuptimtë shfuqizimi i bërë. Përse i prket problemit të qiramarrësve në këto prona, i takon t’i gjejë zgjidhjet shfuqizimi i bërë. Përse i prket problemit të qiramarrësve në këto prona, i takon t’i gjejë zgjidhjet optimale shteti.

ANËTARI
H. Fuga

MENDIMI I PAKICËS

Ndryshe nga shumica, unë jam i mendimit se të gjitha kërkesat e shqyrtuara nga Gjykata Kushtetuese, me objekt shfuqizimin e Ligjit nr.7916, datë 13.04.1995 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin e kompensimin e pronave ish pronarëve”, nuk duhej të ishin pranuar. Zgjidhja në këtë mënyrë e çështjes diktohet nga disa faktorë:

Në radhë të parë, ky ligj i ka kryer funksionet e veta. Pasojat juridike që ka krijuar janë ezauruar në shumicën dërrmuese të rasteve. Ish pronarët, pronat e tyre, të kthyer nga komisionet e kthimit e të kompensimit të pronave i kanë regjistruar në zyrat përkatëse të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Ata, ose i kanë marrë vetë në posedim këto prona, ose kanë zëvendësuar shtetin si qiramarrës, në kontratat e qerasë të lidhura me qytetarët që banojnë akoma në këto ndërtesa, ose me institucionet shtetërore e kulturore që ushtrojnë aty aktivitetin e tyre.

Prania e kësaj rrethane e bën vendimin që u muar me shumicë votash, një akt thujse pa efekt, sepse sfera e zbatimit të tij është shumë e kufizuar. Kjo për arsye se në bazë të nenit 76 të Ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” vendimet e kësaj Gjykate që shfuqizojnë një ligj apo akt normativ si të papajtueshëm me kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, si rregull, sjellin efekte juridike nga data e hyrjes së tyre në fuqi, që është ajo e botimit në Fletoren Zyrtare dhe nuk kanë fuqi prapavepruese ndaj pasojave të ezauruara të ligjit apo aktit normativ të shfuqizuar.

Ky vendim edhe në qoftë se gjen zbatim për raste sporadike, nuk bën gjë tjetër veçse krijon probleme të reja sociale. Nga shfuqizimi i këtij ligji dhe për rrjedhojë nga e drejta e privatizimit të këtyre banesave mund të përfitojnë një pjesë fare e vogël e qeramarrësve, kurse pjesa më e madhe e tyre, përsëri do të vazhdojë të trajtohet si e pastrehë.

Nga ana tjetër, edhe në radhët e ish pronarëve do të lindin pakënaqësi, sidomos për atë pjesë, e cila do të humbasë pronën për shkak se kjo do t'i nënshtrohet efekteve të vendimit të mësipërm.

Së dyti, Gjykata Kushtetuese duhej të dilte me vendim mospranimi, veçanërisht për kërkesën e “Shoqatës së qiramarrësve të banesave shtetërore ish pronë private”. Ajo vetë pranon se kjo e fundit nuk legjitimohet t’u vërë atë në lëvizje për një çështje që është e lidhur me interesat e një grupi tjetër social, siç është shoqata “Pronësi me Drejtësi”, aq më tepër kjo si subjekt i interesuar, mori pjesë në këtë gjykim dhe doli me kërkime diametralisht të kundërta.

Veç kësaj, një zgjidhje e tillë ishte e domosdoshme edhe për arsye të tjera, që kanë të bëjnë me themelin e çështjes. Në këtë drejtim vlen të theksohet fakti, se shkak i vetëm që parashtrohet në këtë kërkesë dhe që sipas kërkuesit përbën shkelje të parimit të barazisë në ligj dhe përpara ligjit, është konsideruar si i pabazuar edhe në themel nga vetë shumica.

Prandaj ishte detyrë e saj, që në këtë rast, duke zbatuar nenin 48 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” ajo të përqëndrohej në shqyrtimin e çështjes vetëm brenda kufijve të shkakut që parashtrohet në këtë kërkesë dhe jo të shfuqizonte ligjin objekt i këtij kontrolli kushtetues për shkaqe të tjera që nuk i ka ngritur kërkuesi.

Së fundi, në ligjin që kundërshtojnë kërkuesit, unë nuk dalloj ndonjë shkelje me karakter kushtetues. Përkundrazi, ky, duke ndryshuar nenin 1 të Ligjit “Për kthimin e kompensimin e pronave” dhe duke e shtrirë veprimin e tij edhe mbi ato pasuri të paluajtshme ish pronë private, të sekuestruara ose të shpronësuar nga shteti totalitar në bazë të ligjit Nr.37, datë 13.01.1945 “Për tatimin e jashtëzakonshëm”, ka pasur parasysh faktin se organet e tij administrative kanë tejkaluar pushtetin e tyre dhe kanë ndjekur praktikisht qëllim të ndryshëm nga ai i parashikuar në këtë ligj të fundit.

Është e vërtetë se ky lloj tatimi, si masë demokratike me karakter fiskal, u zbatua pas Luftës së Dytë Botërore edhe në vendet e Europës Perëndimore, por vetëm kundër atyre personave që kishin realizuar fitime të jashtëligjshme duke përfituar nga vështirësitë dhe mungesat e mëdha të krijuara gjatë luftës. Tek ne ndodhi ndryshe dhe kësaj mase iu nënshtruan pa dallim të gjithë sipërmarrësit privat, pavarësisht nga gjendja e tyre pasurore dhe koha kur kishin filluar aktivitetin privat, para, gjatë apo pas luftës.

Shumë prej tyre nuk qenë në gjendje të shlyenin tatimet e rënda që iu caktoi administrata

shtetërore. Ata jo vetëm falimentuan, por u zhveshën nga e drejta e pronësisë edhe mbi ndërtesat e banimit ose lokalet ku ushtronin veprimtarinë e tyre.

Këto dukuri, tregojnë qartë se Ligji “Për tatimin e jashtëzakonshëm” nuk u përdor vetëm, për qëllime fiskale siç pretendojnë kërkuesit dhe siç pranon shumica në vendimin e saj. Përkundrazi, realiteti i 50 vjetëve të sundimit të shtetit totalitar ka vërtetuar dhe literatura politike e juridike e kohës ka pranuar se ky ligj është përdorur kryesisht si mjet për likuidimin e marrëdhënieve kapitaliste dhe kufizimin gradual të iniciativës së lirë ekonomike private, për të vënë më vonë bazat e një ekonomie socialiste të centralizuar.

Pra kjo veçori që është specifike për vendin tonë hedh dritë mbi faktin se edhe kjo kategori ish pronarësh është zhveshur në mënyrë të padrejtë nga prona. Përfshirja e saj si subjekt që ka të drejtë të përfitojë edhe kjo nga ligji “Për kthimin e kompensimin e pronave” është rrjedhim logjik i politikës dhe i përpjekjeve të shtetit tonë demokratik për ndreqjen e këtyre padrejtësive dhe rivendosjen e të drejtave themelore të shtetasve, të nëpërkëmbura gjatë regjimit të shtetit diktatorial.

Në përgjithësi këto ishin shkaqet për të cilat unë shfaq mendimin për rrëzimin e kërkesave objekt i këtij kontrolli kushtetues.

ANËTAR
A.Vuci

V E N D I M “NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Sabri Rrapi,	Anëtar i ““
Zija Vuci,	Anëtar i ““
Hajredin Fuga,	Anëtar i ““
Alfred Karamuço,	Anëtar i ““
Bardha Selenica,	Anëtare e ““
Kujtim Puto,	Anëtar i ““
Sokol Sadushi,	Anëtar i ““
Kristofor Peçi,	Anëtar i ““

me sekretare Drita Filto e Arbenka Lalica, në datat 19.01.2000 dhe 14.03.2000, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me detyrë të hapura kërkesën me nr. 6 Akti, që i përket:

KËRKUESA: AVOKATËT SHEFQET MUÇI, IDAJET HOXHA E SELFO DOSTI.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i Vendimit nr. 386, datë 29.07.1999 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesit parashirojnë këto shkaqe për shfuqizimin e vendimit:

Vendimi bie ndesh me parimet kushtetuese dhe dispozitat e Kodit të Procedurës Penale që parashikojnë të drejtat e mbrojtësit në procesin penal.

Duke qenë përfaqësues ligjor i të pandehurit në mungesë, mbrojtësi gëzon të gjitha të drejtat e një përfaqësuesi, të gjitha të drejtat e mbrojtësit në mbrojtje të detyrueshme ku përfshihet edhe e drejta e ankimit.

Interpretimi i neneve 50/1, 407/4 e 410 të Kodit të Procedurës Penale nga Kolegjet e Bashkuara, është i gabuar, sepse sipas këtyre neneve mbrojtësit i njihet e drejta e ankimit.

E drejta e ankimit nuk përfshihet në të drejtat ekskluzive që i rezervohen personalisht të pandehurit.

Ne, si mbrojtësa, jemi pajisur me dy akte përfaqësimi të lëshuar në format e parashikuara

nga ligji, prandaj kemi të drejtën e ankimit sipas nenit 410/2 të Kodit të Procedurës Penale.

Vendimi i gjykatës është kontradiktor sepse nuk bën dallim midis të drejtës së ankimit dhe të drejtës për të kërkuar rivendosjen e afatit të humbur për të bërë ankim.

Kolegjet e Bashkuara, kanë prishur vendimin e gjykatës së Apelit, duke pushuar gjykimin në Gjykatën e Lartë, pa u shprehur se ç'duhet bërë me çështjen apo me vendimin e shkallës së parë, kërkesa këto të parashikuara në nenin 441 të Kodit të Procedurës Penale.

GJYKATA KUSHTETUESE,

Pasi dëgjoi shpjegimet e kërkuarit dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin nr.386, datë 29.07.1999, kanë vendosur prishjen e vendimit nr.48, datë 10.03.1999 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe pushimin e gjykimet me arsyetimin se mbrojtësi i caktuar kryesisht ose i pranuar nga gjykata në gjykimet në mungesë, nuk legjitimohet në bërjen e ankimit. Qëllimi i këtij vendimi, është ndryshimi i praktikës gjyqësore të njësuar me vendimin nr.47, datë 28.01.1999 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit mbrojtësi i caktuar kryesisht ose i miratuar nga gjykata, legjitimohet të bëjë ankim kundër vendimit të gjykatës të dhënë në mungesën e të pandehurit.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin nr.386, datë 29.07.1999, duke bërë interpretime të gabuara të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, që parashikojnë të drejtat e mbrojtësit në procesin penal për gjykimet në mungesë të të pandehurit, kanë cënuar parimet kushtetuese të mbrojtjes si dhe të procesit të rregullt ligjor të garantuara nga nenet 31/c dhe 42 të Kushtetutës. Sipas nenit 410/2 të Kodit të Procedurës Penale, kundër vendimit të dhënë në mungesë, mbrojtësi mund të bëjë ankim vetëm kur është i pajisur me një akt përfaqësimi të lëshuar në format e parashikuara nga ligji. Kurse, në nenin 48 të Kodit të Procedurës Penale, përcaktohet se zgjedhja e mbrojtësit për personin e ndaluar, të arrestuar ose të dënuar me burgim, mund të bëhet nga një i afërm i tij me deklaram para organit procedues, ose me akt të dhënë mbrojtësit ose të dërguar atij rekomande.

Në zbatim të këtyre kërkesave ligjore nga të afërmit e të pandehurve, është lëshuar prokura sipas aktit noterial nr. 849 Rep., dhe 257 Kol., datë 13.03.1997. Me këtë prokurë familjarët e të pandehurve Albert Huqi e Baki Huqi, emërojnë si mbrojtës të tyre avokatët Shefqet Muçi e Idajet Hoxha, duke u dhënë të drejtën të realizojnë mbrojtjen në hetimin e çështjes, në gjykatën e shkallës së parë, Gjykatën e Apelit dhe deri në Gjykatën e Kasacionit.

Gjykata Kushtetuese çmon se akti i përfaqësimit është bërë sipas kërkesave të ligjit në bazë të neneve 48 dhe 410/2 të Kodit të Procedurës Penale. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, kanë interpretuar gabim ligjin, duke shkelur një të drejtë themelore të qytetarëve dhe njëkohësisht, kanë zhvilluar një proces të parregullt gjyqësor. Mbrojtësi i të pandehurit që gjykohet në mungesë, i caktuar sipas kërkesave të ligjit gëzon të gjitha të drejtat e mbrojtësit në një mbrojtje të detyrueshme, përfshirë dhe të drejtën e ankimit ndaj vendimit të gjykatës.

Në kundërshtim nga sa arsyetojnë Kolegjet e Bashkuara në vendim, e drejta e ankimit ndaj vendimit të gjykatës nuk është një e drejtë ekskluzive, që i takon vetëm të pandehurit, siç është e drejta për të pranuar ose jo veprën penale, për të bërë ose mos bërë deklarime etj. Sipas ligjit, e drejta e ankimit i takon edhe mbrojtësit si një nga kushtet për realizimin e plotë të mbrojtjes. Në këtë vështrim, është i gabuar arsyetimi që bëjnë Kolegjet e Bashkuara se aplikimi i të drejtës së ankimit nga mbrojtësi i zgjedhur nga të afërmit e të pandehurve, mohon të drejtën e këtyre të fundit për të ushtruar ose jo ankim ndaj vendimit të gjykatës, sepse mbrojtësi nuk është zgjedhur ose pranuar nga vetë të pandehurit. Por, t'i mohosh mbrojtësit ankimin kur këtë të drejtë ia njeh ligji, do të thotë të mos sigurosh mbrojtjen e të pandehurit. E drejta e ankimit ndaj vendimit të fajësisë, si pjesë e së drejtës së mbrojtjes, është në favor të të pandehurit dhe jo në disfavor të tij, prandaj mosushtrimi i saj çënon të drejtat ligjore të të pandehurit.

Përcaktimi në vendimin e Kolegjeve të Bashkuara se mbrojtësi i zgjedhur nga të afërmit e të

pandehurve nuk legjitimohet në bërjen e ankimit ndaj vendimit të gjykatës, cënon parimin kushtetues të mbrojtjes në procesin penal. Para një fakti të tillë dhe për të përligjur sadopak vendimin, arsyetohet se i pandehuri në mungesë nuk humbet të drejtën e ankimit vetëm se duhet të realizojë këtë të drejtë duke kërkuar fillimisht rivendosjen në afat të ankimit. Një arsyetim i tillë, është i pabazuar sepse konfondon të drejtën e ankimit me të drejtën për të kërkuar rivendosjen e afatit të humbur për të bërë ankim. Nga ana tjetër, ai është kontradiktor dhe alogjik, sepse pranon të drejtën e ankimit, por nuk përcakton zgjidhjen praktike dhe ligjore të saj. I pandehuri që gjykohet në mungesë nuk realizon dot vetë as të drejtën e ankimit dhe as atë të rivendosjes në afat, prandaj ligji, në zbatim të parimit kushtetues, ngarkon me këtë detyrë dhe njëkohësisht i jep të drejtë mbrojtësit të caktuar në një nga format e parashikuara në ligj. Të pranosh që i pandehuri që gjykohet në mungesë mund ta realizojë të drejtën e ankimit nëpërmjet rivendosjes në afat, kur ligji i ka garantuar të drejtën e ankimit nga mbrojtësi i zgjedhur nga të afërmit e tij, do të thotë që në fakt të mohosh të drejtën e mbrojtjes, ta reduktosh procesin gjyqësor vetëm në shkallë të parë, gjë që e bën atë të parregullt.

Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara, është rrjedhojë e një procesi të parregullt edhe për një shkak tjetër, sepse nga njëra anë pranohet për shqyrtim rekursi i prokurorit kundër vendimit të pafajësisë dhe nga ana tjetër duke vendosur moslegjitimitimin e mbrojtësit të caktuar nga familjarët, i vë palët në pozita të pabarabarta. Një qëndrim i tillë vjen në kundërshtim edhe me kërkesat e nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe praktikën e Gjykatës Europiane, për respektimin e kërkesave për “barazinë e armëve”, që secilës palë t’i sigurohen mundësitë përkatëse për t’i parashtruar çështjet e saj në kushte që nuk e vënë atë në gjendje shumë më pak të favorshme se sa palën e kundërt.

Moslegjitimimi i mbrojtësit për të bërë ankim sipas konceptit të pranuar nga Gjykata e Lartë, do të thellonte më tej pabarazinë e palëve në proces në rastet kur prokurori ushtron rekursin kundër vendimit të pafajësisë të dhënë nga gjykata e shkallës së parë. Në këto raste, po të pranohej arsyetimi që bëjnë Kolegjet e Bashkuara, mbrojtësi i caktuar sipas ligjit nga familjarët e të pandehurit nuk legjitimohet të bëjë apel kundërshtues dhe as të marrë pjesë në gjykimin e çështjes në shkallët e tjera. Kjo do të bënte që gjykimi në Apel dhe në Gjykatën e Lartë të zhvillohej vetëm me një palë, duke shkelur kështu parimin e rëndësishëm të kontradiktoritetit në procesin penal dhe njëkohësisht procesin e rregullt ligjor.

Nga ana tjetër, argumenti që përdoret në vendim, se pranimi i ankimit të bërë nga mbrojtësi i zgjedhur nga të afërmit e të pandehurve, iu mohon atyre të drejtën të bëjnë vetë ankim ose nëpërmjet mbrojtësit të zgjedhur prej tyre, përbën një arsyetim të gabuar e jologjik që ka cënuar të drejtën e mbrojtjes në procesin penal. Ankimi që bëhet ndaj vendimit të fajësisë të gjykatës nga cilido mbrojtës i caktuar në kushtet e parashikuara nga ligji, ka për qëllim mbrojtjen e interesave të ligjshme të të pandehurit. Përkundrazi, moslejimi i ankimit, cënon të drejtën e mbrojtjes dhe shqyrtimin e çështjes nga një instancë më e lartë gjykimi.

Caktimi i mbrojtësit në mënyrat dhe kriteret e parashikuara nga ligji, përfshirë dhe mbrojtësin e caktuar kryesisht dhe njëkohësisht, e drejta e tyre për të bërë ankim ndaj vendimit të gjykatës, ka për qëllim respektimin e procesit të rregullt ligjor në të gjitha shkallët e gjykimit, siç përcaktohet edhe në nenin 2/2 të Protokollit nr.7 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenit 14/5 të Paktit Nërkkombëtar për të Drejtat civile dhe politike.

Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për moslegjitimitimin e mbrojtësit të zgjedhur nga të afërmit e të pandehurve, është i pabazuar edhe për shkak të inkonsekuençës së tij. Kështu, pranohet që mbrojtësi nuk legjitimohet të bëjë ankim ndaj vendimit të gjykatës, por nuk përmendet fare nëse ai ka të drejtë të marrë pjesë në gjykimin e çështjes në shkallë të parë ose në hetimet paraprake. Një qëndrim i tillë, është kontradiktor, sepse në rast se mbrojtësi i caktuar nga të afërmit e të pandehurve nuk do të legjitimohej për arsyet e përmendura në vendimin e Kolegjeve të Bashkuara, atëherë ky moslegjitimim i shtrin efektet që nga fillimi dhe jo vetëm për ankimin ndaj vendimit të gjykatës.

Cënimi i procesit të rregullt ligjor të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, pasqyrohet edhe në një aspekt tjetër në vendimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Kështu, dispozitivi i vendimit vjen në kundërshtim me nenin 441 të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon mënyra

të tjera të zgjidhjes së çështjes dhe jo pushimin e gjykimit në Gjykatën e Lartë. Veç kësaj, në vendimin e Kolegjeve të Bashkuara, nuk shprehet se ç'duhet bërë me çështjen në gjykim, cila është mënyra e përfundimit të saj etj., kërkesa këto të parashikuara në nenin 441 të Kodit të Procedurës Penale, në të cilin mbështetet vendimi. Për më tepër, duke pushuar gjykimin në Gjykatën e Lartë, është lënë pa zgjidhur çështja konkrete mbi fajësinë ose pafajësinë e të pandehurve.

Përsa përmendëm më lart, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se vendimi nr. 386, datë 29.07.1999 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duhet të shfuqizohet si antikushtetuese, sepse ka mohuar të drejtën e mbrojtjes në procesin penal, duke zhvilluar një proces gjyqësor të parregullt.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131 dhe 134 të Kushtetutës dhe të neneve 72, 77 e 86 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I:

Shfuqizimin si antikushtetues të Vendimit nr. 386, datë 29.07.1999 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Çështja i dërgohet për shqyrtim Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë .

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 17.04.2000
Nr.6 i Regj. Themeltar.
Nr.17 i Vendimit.

MENDIMI I PAKICËS

Jemi kundër vendimit të shumicës në çështjen e kërkesve: avokat Shefqet Muçi, etj., për shfuqizimin e vendimit nr. 386, datë 29.07.1999 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për këto arsye:

Gjykata e Lartë, bazuar në të drejtën që i njeh Kushtetuta në nenin 141, paragrafi i dytë, ka tërhequr çështjen që i përket të pandehurve Albert Huqi, etj., me qëllim njëhësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore.

Nëpërmjet vendimit të saj, Gjykata e Lartë, ka interpretuar dispozitat e neneve 48, 50 dhe 410 të Kodit të Procedurës Penale dhe përfundimisht ka konkluduar se mbrojtësi i caktuar kryesisht, qoftë ky edhe i zgjedhur nga të afërtit, në gjykimet në mungesë, nuk legjitimohet të bëjë ankim, pa qenë i pajisur me akt përfaqësimi nga i pandehuri.

Gjykata Kushtetuese, në vendimin e saj u bën një interpretim të ndryshëm kuptimit të neneve 48, 50 dhe 410 të Kodit të Procedurës Penale.

Sipas mendimit tonë, neni 48 i Kodit të Procedurës Penale, tregon mënyrat dhe format e zgjedhjes së mbrojtësit nga i pandehuri, kurse në paragrafin e tretë të nenit 48, njihet e drejta e zgjedhjes së mbrojtësit nga një i afërm, por ekzistojnë dy rrethana: së pari, që personi të jetë i ndaluar, i arrestuar ose i dënuar me burgim, pra të jetë në gjendje izolimi dhe për shkak të kësaj gjendjeje është e pamundur të zgjedhë vetë mbrojtës dhe së dyti, i afërmi mund të zgjedhë mbrojtës për një person derisa i pandehuri të shprehet vetë për mbrojtësin. Kjo del qartë nga përmbajtja e paragrafit të tretë të nenit 48 të Kodit të Procedurës Penale. Pra, rregulli i përgjithshëm është që e drejta për të zgjedhur mbrojtës i takon të pandehurit dhe përjashtimisht, kur personi ndodhet në kushte izolimi (ndalim, arrestim apo dënim me burgim), mbrojtësin mund ta zgjedhë i afërmi i tij. Kur hetimi ose gjykimi zhvillohet në mungesë, caktimi i mbrojtësit, përsëri kur i pandehuri nuk e ka

zgjedhur vetë, bëhet përkatësisht nga organi i prokurorisë ose gjykata. Jashtë këtyre rasteve përjashtimore, ndërhyrja e të tjerëve për t'i caktuar mbrojtës të pandehurit, sipas mendimit tonë, dhunon të drejtën e mbrojtjes, sepse kjo e drejtë i takon të pandehurit, i cili vendos vetë nëse dëshiron ose jo të ketë mbrojtës.

Në nenin 50 të Kodit të Procedurës Penale, përcaktohet se mbrojtësi ka të drejtat që ligji i njej të pandehurit, përveç atyre që i rezervohen personalisht të pandehurit. Në vendimin e Gjykatës Kushtetuese, pranohet se e drejta e ankimit nuk përfshihet në të drejtat që i rezervohen personalisht të pandehurit. Sipas mendimit tonë, edhe ky kuptim që i jepet nenit 50, paragrafi i parë të Kodit të Procedurës Penale, nuk është i saktë. E drejta e ankimit përfshihet në të drejtat që i rezervohen të pandehurit. Është i pandehuri që vendos për të realizuar të drejtën e ankimit. Kjo do të thotë, që mbrojtësi nuk mund të bëjë ankim kur i pandehuri nuk dëshiron dhe e kundërta, mbrojtësi nuk mund të mos bëjë ankim kur i pandehuri dëshiron të ankohet. Këtë kuptim i ka dhënë nenit 50 të Kodit të Procedurës Penale si praktika e Gjykatës së Apelit Tiranë, ashtu edhe literatura (teksti i Kodit të Procedurës Penale).

Në titullin e VIII-të të Kodit të Procedurës Penale, përcaktohen rregullat e përgjithshme të ankimit. Në nenin 410, paragrafi i dytë, parashikohet se kundër vendimit të dhënë në mungesë, mbrojtësi mund të bëjë ankim vetëm kur është i pajisur me një akt përfaqësimi të lëshuar në format e parashikuara nga ligji. Pra neni 410 të referon tek neni 48 i Kodit të Procedurës Penale, jo për mënyrën e caktimit të mbrojtësit, por për format se si realizohet caktimi i mbrojtësit (me deklaram ose me akt të dhënë mbrojtësit apo të dërguar rekomande). Dispozita e nenit 410, paragrafi i dytë, është i qartë dhe nuk lë shteg për t'u kuptuar ndryshe, siç është trajtuar në vendimin e shumicës, sipas të cilit edhe në rastin e gjykimit në mungesë, ankimin mund ta ushtrojnë edhe të afërmit ose mbrojtësi i autorizuar prej tyre. Duke qenë e drejta e ankimit, një e drejtë që i rezervohet personalisht të pandehurit, askush tjetër, përveç këtij nuk mund të vendosë për të ushtruar ose jo ankim ndaj vendimit.

Duke pasur mendime të njëjta me interpretimin që u ka bërë këtyre dispozitave Gjykata e Lartë, çmojmë se vendimi i saj është i drejtë dhe nuk ka shkaqe për shfuqizimin si antikushtetues.

Në rast se dispozitat procedurale që citohen më lart, janë ose jo në pajtim me Kushtetutën, kjo do të përbënte një çështje tjetër, me objekt tjetër dhe pikërisht me papajtueshmërinë e tyre me Kushtetutën, për të cilën nuk legjitimohen kërkesit të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese.

ANËTAR

K. Puto

ANËTAR

H. Fuga

V E N D I M “NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci,	Anëtar i	““
Alfred Karamuço,	Anëtar i	““
Kristofor Peçi,	Anëtar i	““
Bardha Selenica,	Anëtare e	““
Kujtim Puto,	Anëtar i	““
Sokol Sadushi,	Anëtar i	““
Hajredin Fuga,	Anëtar i	““

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 09.03.2000 dhe mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën me nr. 15 Akti, që i përket:

KËRKUESE: SOFIJE ZHILLA, e përfaqësuar nga avokat Agim Dishnica, me prokurë.

SUBJEKTI I INTERESUAR: KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË, i përfaqësuar nga Alfred Progonati, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues të Vendimit nr.756 datë 29.06.1999 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Kërkuese Sofije Zhilla, ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të mësipërm:

- Gjykimi në Gjykatën e Lartë, nuk është rrjedhojë e një procesi të rregullt ligjor, në kundërshtim me nenin 42 paragrafi i parë të Kushtetutës, sepse nuk është administruar si provë kaseta filmike duke u shkelur neni 29 i Kodit të Procedurës Civile, se nuk janë respektuar e drejta për t'u njohur me të dhënat e mbledhura, e drejta për t'u dëgjuar para se të dënohet, e drejta e tubimeve paqësore, të përcaktuara këto respektivisht nga nenet 35, 33 dhe 47 të Kushtetutës, si dhe e drejta e parashkuar nga neni 32 paragrafi 2, sipas të cilit "Askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme";

- Materiali i dërguar nga Inspektoriati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, nuk është marrë në konsideratë si nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë ashtu edhe nga Gjykata e Lartë;

- Në gjykim nuk u bë hetim gjyqësor. Nuk u sqarua shkelja e bërë dhe nëse veprimi i kryer përbën shkelje disiplinore sipas nenit 41 të ligjit nr. 8436, datë 28.12. 1998;

- Gjykata e Lartë në vend që të zgjidhë detyrat sipas neneve 324 e vijues të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 92/a të Kodit Civil, është marrë me justifikimin e veprimeve të paligjshme të prokurorisë.

Në seancë gjyqësore, pala kërkuese shtoi se procesi i parregullt ligjor konsiston në mosrespektimin nga Gjykata e Lartë e parimit të hetimit të plotë dhe parimi i kontradiktoritetit të parashkuara këto respektivisht nga nenet 14, 20, e 213 të Kodit të Procedurës Civile.

GJYKATA KUSHTETUESE,

Pasi dëgjoi palën kërkuese që u shpreh për pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që kërkoi rrëzimin e kërkesës si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N :

Shkaqet e parashtruara në kërkesë dhe në seancë gjyqësore, për deklarimin si antikushtetues të vendimit nr. 756, datë 29.06.1999 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk përbëjnë argumente për shfuqizimin e vendimit të mësipërm e për rrjedhojë kërkesa duhet rrëzuar.

Sipas nenit 131 germa "f" të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese vendos për gjykim përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Në vështrim të kësaj dispozite, Gjykata Kushtetuese merr në konsideratë vetëm ato pretendime që lidhen me procesin e rregullt ligjor dhe jo çdo pretendim të parashtruar nga individit për parregullsi në gjykimin e çështjes. Për rrjedhojë, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të vlerësojë nëse Gjykata e Lartë, si instancë që gjykon ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i ka mbledhur ose jo të gjitha provat e propozuara nga të dy palët për të konkluduar mbi vërtetësinë e faktit që i atribuohet ankuesit. Në të njëjtën kohë nuk është e drejtë e Gjykatës Kushtetuese të vlerësojë vendimin e Gjykatës së Lartë, nëse fakti i pranuar si i vërtetë prej saj përbën shkelje dhe nëse kjo shkelje është ose jo e rëndë. Këto çështje i takojnë për zgjidhje Gjykatës së Lartë, e cila, në përputhje me procedurën dhe brenda pretendimeve të ngritura nga palët, mbledh ato prova që ajo i vlerëson të mjaftueshme për të, për të konkluduar mbi ankimin e paraqitur dhe ligjshmërinë e vendimit të ankimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Në rastin konkret të kërkueses Sofije Zhilla, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke vlerësuar pretendimet e parashtruara në ankimin e kërkueses si dhe duke shqyrtuar materialet që përmban çështja, kanë arritur në përfundimin se veprimet e kërkueses të kryera më datën 14 shtator 1998, në veprim të neneve

29,34,40 e 41 pikat 1 e 6 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, përbëjnë shkelje disiplinore që justifikojnë masën disiplinore të aplikuar ndaj saj. Duke u parë problemi në këtë këndvështrim, pretendimet e ngritura nga kërkuesja para Gjykatës Kushtetuese, për hetim jo të plotë të çështjes si dhe për mosmarrjen nga Gjykata e Lartë e të gjitha provave të kërkuara nga palët, përfshi këtu edhe mosadministrimin e kasetës filmike, apo pretendimet në lidhje me natyrën e shkeljes dhe vlerësimin e saj, nuk kanë lidhje me procesin e rregullt ligjor, prandaj nuk mund të shërbejë si shkak shfuqizimi si antikushtetues të vendimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Gjykata Kushtetuese çmon se rezultojnë të pabazuara pretendimet e kërkueses se nuk janë respektuar e drejta për t’u njohur me të dhënat e mbledhura rreth saj si dhe e drejta për t’u dëgjuar, të parashikuara respektivisht nga nenet 35 e 33 të Kushtetutës. Nga tërë materialet që disponon dosja, rezulton se kërkuesja është njohur më parë nga Inspektoriati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë me shkaqet e shkeljes për të cilat është nisur procedimi disiplinor, është njoftuar dhe ka marrë pjesë në mbledhjen e Këshillit të Lartë të Drejtësisë së bashku me avokatët ku është dëgjuar, ka dhënë sqarime, ka kundërshtuar akuzat dhe u është përgjigjur pyetjeve të drejtuara asaj. Pasi i është komunikuar vendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ka paraqitur ankim në Gjykatën e Lartë, është njoftuar dhe ka marrë pjesë në seancën e zhvilluar nga Kolegjet e Bashkuara dhe nëpërmjet përfaqësuesit ka parashtruar argumentet që sipas saj e bëjnë vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të pabazuar. Në këtë aspekt, nuk qëndron as pretendimi i ngritur në seancë për shkelje të parimit të kontradiktoritetit, sepse nga mënyra se si është proceduar jo vetëm në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, por edhe nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vendimi i të cilit kërkohet të shfuqizohet, ky parim është respektuar, konform neneve 18, 19 e 20 të Kodit të Procedurës Civile.

Përsa i përket pretendimit për thirrjen dhe deklarimet e bëra nga kërkuesja para organit të prokurorisë, që në vështrim të nenit 32 paragrafi i dytë të Kushtetutës e konsideron si një veprim antikushtetues, nga tërësia e materialit të çështjes rezulton se ajo nuk është thirrur për t’iu nënshtruar ndjekjes penale, por me cilësinë e personit që mund të tregojë rrethana të dobishme për qëllimet e hetimit, konform nenit 303 pika 2, germa “c” të Kodit të Procedurës Penale. Këto deklarime kërkuesja nuk i konteston si përsa i përket vërtetësisë, ashtu edhe mënyrës së marrjes së tyre, kështu që ajo nuk është gjetur fajtorë për shkeljen mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Në kuptim të nisjes së procedimit disiplinor, për ministrin e Drejtësisë, nuk ka rëndësi se nga i vijnë sinjalizimet, por e rëndësishme është vërtetësia e tyre, që siç u përmend, kërkuesja nuk e ka vënë ndonjëherë në dyshim në tërë organet që janë marrë me shqyrtimin e rastit të saj. Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i është paraqitur edhe një informacion nga Inspektoriati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në lidhje me një shkelje që i atribuohet kërkueses. Në mbledhje të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, rreth këtij informacioni janë bërë diskutime dhe kundërshtime, ndërsa në Gjykatën e Lartë, ky material nuk është marrë në konsideratë dhe për të nuk bëhet fjalë as në vendimin e Kolegjeve të Bashkuara. Fakti që ky informacion nuk është marrë në konsideratë nga Gjykata e Lartë, nuk është në disfavor të saj, sepse nuk ka ndikuar në zgjidhjen e çështjes, kështu që edhe shkak që parashtrohet nuk mund të shërbejë si argument për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131 e 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe të nenit 72 të Ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “ Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletore Zyrtare.

Tiranë, më 18. 04.2000
Nr.15 i regj. Themeltar.
Nr.18 i Vendimit.

MENDIMI I PAKICËS

Vendimi nr.756, datë 29.06.1999 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duhet të ishte shfuqizuar si antikushtetues, sepse është pasojë e një procesi të parregullt në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

Procesi i parregullt konsiston në mosrrespektimin e parimeve të hetimit të plotë dhe të kontradiktoritetit të parashikuar nga nenet 14, 20 e 213 të Kodit të Procedurës Civile. Shqyrtimi nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë i ankimit ndaj vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, siç përcaktohet në nenin 147 të Kushtetutës, dallon nga shqyrtimi i zakonshëm i çështjes në tre shkallët e gjykimit. Për rëndësinë që kanë çështjet e shkarkimit të gjyqtarëve, ankimi ndaj vendimit bëhet drejtpërdrejt në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të cilat në këtë rast janë të detyruara të zbatojnë rregullat procedurale të gjykimit në shkallë të parë. Ky gjykim, presupozon marrje dhe verifikimin e provave, zbatimin e parimit të kontradiktoritetit, duke pasqyruar veprimet në procesverbalin e seancës. Por, nga Kolegjet e Bashkuara, në gjykimin e çështjes nuk është mbajtur fare procesverbal, gjë që e bën procesin të parregullt.

Shkelje tjetër e kërkesave për një proces të rregullt ligjor të parashikuar edhe nga neni 6 i Konventës Europiane të Drejtave të Njeriut, është se gjykimi në Kolegjet e Bashkuara, është bërë formal, duke i marrë apriori si të vërteta konstatimet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe pa administruar si provë kasetën filmike. Meqënëse, kërkuesja nuk e ka mohuar pjesëmarrjen në ceremoninë mortore, ishte detyrë e gjykatës që nëpërmjet administrimit të kasetës filmike të provonte se ka kryer veprime që kompromentojnë figurën e gjyqtarit. Sipas nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile, në procesverbal pasqyrohet edhe përmbatja e shiritave të magnetofonit, të diapozitivave, filmimeve, të cilat i bashkohen akteve të çështjes. Prandaj, mungesa e procesverbalit dhe e administrimit të provave e bën procesin të parregullt.

Në vendimin e Kolegjeve të Bashkuara, arsyetohet se kërkuesja nuk e ka kundërshtuar pjesëmarrjen në demonstrim dhe prandaj nuk administrohet kaseta filmike si provë. Ky arsyetim, është i pabazuar. Kërkuesja, ka pretenduar se nuk ka kryer veprime që kompromentojnë figurën e gjyqtarit dhe për të provuar këtë, përveç thënjeve të saj, kërkohet të administrohet edhe kaseta filmike. Në këto rrethana, mosadministrimi i saj, përbën shkelje të rëndë dhe proces të parregullt, duke dhënë vendim pa marrë provat e nevojshme në kundërshtim me nenin 42 të kushtetutës dhe nenit 6/2 të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut, sipas të cilës, çdo person i akuzuar për shkelje të ligjit prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht. Sipas praktikës së Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut, parimi i prezumimit të pafajsisë, duhet të zbatohet detyrimisht jo vetëm nga gjykatat për çështjet penale, por edhe nga organet e tjera. Gjithashtu, kjo Gjykatë në disa vendime të saj tërheq vëmendjen se neni 6 i Konventës nuk ka për qëllim të mbrojë të drejtat në mënyrë teorike ose zhgënjyese, por të garantojë zbatimin efektiv dhe real të tyre.

Gjithashtu, arsyetimi tjetër se: “Veprimtaria ku ka marrë pjesë gjyqtarja Sofije, i ka kaluar në mënyrë ekstreme caqet e një demonstrimi politik normal dhe është shndërruar në një veprimtari antikushtetuese e kriminale”, mendoj se nuk është i bazuar përse i përket përgjegjësisë së kërkueses. Është tjetër gjë të thuhet se veprimtaria është shndërruar në antikushtetuese e kriminale dhe tjetër është përgjigjësia që mund të ketë për këtë kërkuesja, përgjegjësi e cila duhet të provohet me hetim të plotë të çështjes. Nga ana tjetër, ky argumentim është kontradiktor, sepse pranohet që veprimtaria është antikushtetuese e kriminale dhe për këtë ka përgjegjësi kërkuesja, por për këto vepra kaq të rënda nuk është filluar procedimi penal. Kjo kontradiktë e bën vendimin alogjik e për rrjedhojë të paligjshëm.

Në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, është diskutuar edhe për një shkelje tjetër që i atribuohet kërkueses, por që nuk përmendet fare në vendimin e Kolegjeve të Bashkuara. Mospërmendja e këtij

fakti në vendim është në disfavor të kërkueses, sepse edhe kjo shkelje është konsideruar si e kryer pa u hetuar, ashtu si rasti tjetër që u përmend më lart. Që vendimi i Kolegjeve të Bashkuara përmban shkelje të tilla serioze që e bëjnë procesin të parregullt e tregon edhe fakti që nga 12 gjyqtarët që kanë marrë pjesë, 5 kanë votuar kundër.

ANËTAR
K.Peçi

V E N D I M “NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci,	Anëtar i	““
Hajredin Fuga,	Anëtar i	““
Alfred Karamuço,	Anëtar i	““
Kristofor Peçi,	Anëtar i	““
Bardha Selenica,	Anëtare e	““
Sokol Sadushi,	Anëtar i	““
Kujtim Puto,	Anëtar i	““

me sekretare Arbenka Lalica, më datë 28.02.2000, mori në shyrtrim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën me nr.9 Akti, që i përket:

KËRKUES: RAMIZ LALA

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues të Vendimit nr.1114, datë 07.12.1999 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë”.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të sipërm:

1. Para seancës së datës 07.12.1999 është zhvilluar seanca e datës 28-29 shtator 1999 në të cilën, pasi u mbyll hetimi gjyqësor, u vendos që në fund të muajit tetor 1999, të jepet vendimi përfundimtar. Kryesuese ishte gjyqtarja Vitore Tusha.

2. Në seancën e dytë, nuk u dha vendimi përfundimtar, por filloi gjykimi nga fillimi. Me kërkesën time, hoqën dorë kryetari me dy gjyqtarë, që kishin marrë pjesë në vendimet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Hoqën dorë me nismën e tyre edhe gjyqtarët e tjerë që kishin marrë pjesë në gjykimin e mëparshëm.

3. Vendimi i pezullimit i Kolegjeve të Bashkuara nuk më zgjidh e nuk më garanton të drejtat e mia themelore, siç është ajo e kthimit në punë si gjyqtar.

GJYKATA KUSHTETUESE

Pasi dëgjoi shpjegimet e kërkuetit që kërkoi pranimin e kërkesës, administroi provat dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Vendimi nr.1114, datë 07.12.1999 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, është rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Vendimi i mësipërm i nënshkruar nga tre anëtarë, vjen në kundërshtim me nenin 8 të Ligjit nr 8362, datë 01.07.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Kasacionit dhe administrimin e shërbimeve

gjqësore”, që ishte në fuqi në kohën e gjykimit, që përcaktonte se Kolegjet e Bashkuara mund të gjykonin kur në seancë merrnin pjesë jo më pak se dy të tretat e gjyqtarëve. Ky vendim, tejkalon edhe përmbajtjen e nenit 297 të Kodit të Procedurës Civile që trajton rastet e pezullimit të gjykimit. Jo vetëm kaq, por sipas nenit 145 të kushtetutës, pezullimi i gjykimit dhe dërgimi i çështjes në Gjykatën Kushtetuese mund të bëhet kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijjnë në kundërshtim me Kushtetutën dhe përderisa Kolegjet e Bashkuara nuk kanë arritur në një konkluzion të tillë nuk duhet të pezullonin gjykimin.

Në seancën e datës 7 dhjetor 1999, janë larguar nga gjykimi jo vetëm gjyqtarët që kanë marrë pjesë në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, por edhe gjyqtarët që kanë shfaqur mendimin në gjykimin e mëparshëm të kësaj çështje në Kolegjet e Bashkuara. Është e vërtetë që neni 72/4 I Kodit të Procedurës Civile, detyron gjyqtarin të heqë dorë kur ka shfaqur mendimin në gjykimin e çështjes në një shkallë tjetër të procesit. Po kështu është e vërtetë se neni 473 paragrafi i fundit, nuk lejon që të zhvillohet më shumë se një herë gjykimi i një çështje në Kolegjet e Bashkuara, por në rastin konkret si rigjykimi ashtu dhe pjesëmarrja e gjyqtarëve në rigjykim, nuk ka pengesë ligjore, sepse çështja shqyrtohet në Kolegjet e Bashkuara pas shfuqizimit të vendimit të mëparshëm si antikushtetues për proces jo të rregullt ligjor nga Gjykata Kushtetuese.

Duke u përjashtuar nga gjykimi i çështjes shumica e anëtarëve të Kolegjeve të Bashkuara dhe, duke u pezulluar gjykimi i çështjes, nuk i është dhënë përgjigje kërkesës së kërkuarit. Jo vetëm kaq, por me largimin e tyre, Kolegjet e Bashkuara, nuk mund të kryejnë dot funksionet dhe krijohet krizë institucionale, sepse janë i vetmi organ që ka kompetencë gjykimin e kërkesave të gjyqtarëve ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Kolegjet e Bashkuara e interpretojnë në mënyrë të gabuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.48, datë 30.07.1999. Në këtë vendim kjo Gjykatë nuk trajton papajtueshmërinë e funksionit të anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë me atë të anëtarit të Gjykatës së Lartë, por pranon se çenohet parimi i paanësisë nga marrja pjesë e një personi në shqyrtimin e çështjes konkrete si anëtar i Gjykatës së Lartë dhe si anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në të cilin ka votuar për të larguar gjyqtarin nga puna.

Cënimi i parimit të paanësisë nga pjesëmarrja e një anëtari në organin që e largon nga puna dhe në organin që gjykon ankesën, merr rëndësi të veçantë gjatë trajtimit të problemit në aspektin kushtetues, sepse ka të bëjë me mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut. Në shoqëri demokratike ka shumë rëndësi besimi i individit te organi drejtësisë, dhe është detyra e Kolegjeve të Bashkuara si e çdo organi tjetër gjykimi, që ta mbështesë e stimulojë këtë besim, por gjithmonë duke zhvilluar një proces të rregullt ligjor e duke kryer detyrat funksionale e kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 132 të Kushtetutës dhe neneve 72, 77 dhe 86 të Ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

Shfuqizimin si antikushtetues të Vendimit nr.1114, datë 07.12.1999 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim Gjykatës së Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 18.04.2000
Nr.9 i Regj. Themeltar.
Nr.19 i Vendimit.

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Hajredin Fuga,	Anëtar i	““
Alfred Karamuço,	Anëtar i	““
Kristofor Peçi,	Anëtar i	““
Bardha Selenica,	Anëtare e	““
Kujtim Puto,	Anëtar i	““
Sokol Sadushi,	Anëtar i	““
Zija Vuci,	Anëtar i	““

me sekretare Arbenka Lalica, më datë 17. 03. 2000, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën me nr. 18 Akti, që i përket:

KËRKUES: ILIR SULA, i përfaqësuar nga avokat Arben Akani, me deklaram.

OBJEKTI: Deklarim antikushtetues të Vendimeve nr. 998, datë 03. 12.1998 të Gjykatës së rrethit Tiranë dhe nr. 378, datë 23.06. 1999 të kolegjit penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 27, 31 germa “b” e “d”, 33 pikat 1, 42, 49,131 germa “f”, 134 germa “g” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetues të këtyre vendimeve:

Në gjykimin e shkallës së parë dhe në atë të zhvilluar pranë kolegjit penal, çështja në ngarkim të tij është shqyrtuar pa u respektuar kërkesat e neni 42/1 të Kushtetutës, i cili bën fjalë për procesin e rregullt ligjor.

Gjykata e rrethit Tiranë, e ka deklaruar fajtor për veprën penale të parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal, pa u verifikuar deri në fund pretendimet e tij.

Ai ka insistuar të administrohet si prova dy procesverbale kallëzimi dhe të pyeteshin si dëshmitarë autorët e këtyre kallzimeve, të cilët janë dëmtuar nga veprimtaria kriminale e të ndaluarit Arben Alia edhe pas daljes së ligjit “Mbi Amnistinë”. Megjithëse marrja e këtyre provave kishte rëndësi për zgjidhjen e çështjes, gjykata pa vend nuk pranoi t’i administrojë, gjë që tregon se ky proces gjyqësor ishte jo i rregullt.

Kjo parregullsi ka vazhduar edhe në gjykimin e zhvilluar pranë Gjykatës së Lartë, por në formë tjetër. Kolegji penal e ka shqyrtuar çështjen në mungesë të kërkuesit, pa i komunikuar atij më parë ankimin që ka bërë kundër vendimit të Gjykatës së Apelit prokurori pranë kësaj Gjykate. Kërkuesi ka pretenduar se ai nuk është njohur fare me shkaqet e këtij ankimi dhe ka pasur dijeni për ditën e gjykimin në Gjykatën e Lartë. Ai ka parashtruar gjithashtu se, edhe avokati që ka marrë pjesë në këtë gjykim nuk ka qenë i autorizuar prej tij për ta përfaqësuar atë në Gjykatën e Lartë.

Prandaj, për këto arsye kërkuesi ka kërkuar deklaramin antikushtetues të dy vendimeve të sipër përmendura.

GJYKATA KUSHTETUESE,

Pasi dëgjoi shpjegimet e kërkuesit, përfaqësuesit të tij dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kërkuesi Ilir Sula, ish-shef i ndjekjes së krimeve pranë Komisarariatit të rrethit Kukës, me vendim nr.998, datë 03.12.1998 të Gjykatës së rrethit Tiranë, është deklaruar fajtor për veprën

penale të veprimeve arbitrare ndaj shtetasit Arben Alia dhe në bazë të nenit 250 të Kodit Penal, është dënuar me kohën e qëndrimit të tij në arrest me burg dhe më pas, në arrest shtëpiak.

Mbi ankimin e kërkuarit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.30, datë 01.02. 1999 ka vendosur prishjen e vendimit të sipërm dhe pushimin e çështjes në ngarkim të tij. Duke mos u pajtuar me këtë zgjidhje, prokurori pranë kësaj gjykate ka ushtruar rekurs kundër këtij vendimi. Kolegji penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 378, datë 23.06.1999 e ka prishur atë dhe ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit Tiranë.

Ashtu siç parashtrohet edhe në kërkesën drejtuar gjykatës Kushtetuese, nga shqyrtimi që kjo i bëri asaj në seancë plenare, rezultoi se gjykimi i zhvilluar në Gjykatën e Lartë është shoqëruar me shkeljen e parimit të sanksionuar në paragrafin e parë të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë ose me ligj, nuk mund të cënohen pa një proces të rregullt ligjor.

Konkretisht, kolegji penal i Gjykatës së Lartë, çështjen e ka gjykuar në mungesë të kërkuarit, pa pasur ky si i pandehur dijeni për ditën e gjykimit. Madje, edhe pasi e ka caktuar atë për gjykim, ai nuk ka marrë masa për t'i bërë atij të njohur jo vetëm shkaqet e ankimit, por as faktin e vënies së saj në lëvizje nga ana e prokurorit.

Avokati që e ka mbrojtur kërkuarin në Gjykatën e Rrethit në Gjykatën e Apelit, është lejuar të marrë pjesë si mbrojtës i tij edhe në gjykimin e zhvilluar pranë Gjykatës së Lartë, pa qenë ai i pajisur sipas rregullit me akt përfaqësimi të lëshuar në format e parashikuara nga ligji.

Mungesa e këtij akti, bën që një mbrojtje e tillë të jetë e pa vleshme dhe të mos prodhojë asnjë efekt, si për gjykatën ashtu edhe për të pandehurin. Kjo parregullsi në gjykimin e çështjes e ka burimin në mosrespektimin e kërkesave të nenit 437, pika 4 të Kodit të Procedurës Penale. Në vështrim të kësaj dispozite, nëqoftëse Kryetari i Kolegjit Penal do të kishte verifikuar legjitimitin e avokatit si mbrojtës i të pandehurit, do të kishte konstatuar se ky nuk legjitimohej dhe për rrjedhojë, nuk do të kishte lejuar të merrte pjesë në këtë gjykim.

Është e qartë se shkelje të kësaj natyre, që cënojnë parimin e mbrojtjes në gjyq, ndikojnë drejtëpërsëdrejti në dhënien e drejtësisë dhe përbëjnë një nga format e procesit të parregullt ligjor.

Përsa i përket pretendimit tjetër të kërkuarit, lidhur me mosmarrjen e provave të kërkuara prej tij gjatë gjykimit në shkallë të parë, Gjykata Kushtetuese çmon se ky qëndrim i gjykatës që ka shqyrtuar çështjen konkrete, nuk ka të bëjë me mosrespektimin e kërkesave të procesit të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, nuk është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese të zgjidhë këtë problem juridik. Nëse ky gjykim, është shoqëruar me mangësi në hetime ose me vlerësim të gabuar të provave, kjo është një çështje që i takon vetëm juridiksionit gjyqësor, d.m.th., është gjykata e zakonshme më e lartë, ajo që me ligj është autorizuar për ndreqjen e këtyre të metave të pretenduara nga kërkuari.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës dhe nenit 72, 77 dhe 86 të Ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë",

V E N D O S I :

Shfuqizimin si antikushtetues të Vendimit nr.378, datë 23.06.1999 të kolegjit penal të Gjykatës së Lartë. Çështja i dërgohet për shqyrtim kolegjit penal po të kësaj gjykate.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë më 18.04.2000
Nr.18 i Regj. Themeltar.
Nr.20 i Vendimit.

U dorëzua për shtyp më 9.5.2000
Doli nga shtypi më 10.5.2000

Tirazhi: 3700 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Tipografia Ushtarake"

Çmimi: 100 lekë